



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

OSNOVNI SUD MITROVICA - BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.133/2012

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur ne objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual **Faton Ademi**, në çështjen juridike të paditëses: _____, dega në _____ cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson zyrtari ligjor _____ kundër të paditurit: _____ nga _____, baza e kontestit: Kthimi i Kredisë, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës: 25.03.2014 me datën 17.04.2014 bie këtë:

A K T G J Y K I M

- **OBLIGOHET** i padituri _____ si shfrytëzues i kredisë, që në emër të kthimit të kredisë t'ia paguaje paditëse shumën prej 1811.61 euro brenda afatit 15 ditor nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm
- **OBLIGOHET**, i padituri që në emër të shpenzimeve procedurale, t'ia paguajë paditëses shumën prej 20 euro dhe ate në emer të takses per padi, ndersa ne emer shpenzimeve gjyqësore-përpilimin te ketij aktgjykimi, gjykates t'ia paguaj shumen prej 20 euro, të gjitha në afat 15 ditor nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja me datë: 06.06.2012 ka parashtruar në gjykatë padi për kthimin e kredië, kundër të paditurit.

Gjykata ka mbajtur seancën përgatitore me datë: 21.01.2014 në mungesë të palës së paditur të ftuar me rregull.

Në këtë seancë përfaqësuesi I palës paditëse bëri precizimin- zvoglimin e kërkesëpadisë ku tani kërkoi që nga gjykata që ta obligon të paditurin që t'ia kthej bankës-paditëses shumën prej 1811.61 euro, pasi në ndërkohë I padituri I ka paguar herë pas herë këstet, ndërsa përfaqësuesi I paditëses deklaroi se hjek dorë nga kammat ndëshkuese.

Me datë: 25.03.2014 është mbajtur seance kryesore, edhe kjo seance u mbajt në mungesë të të paditurit, pasi familjarët e të njëjtit kishin refuzuar pranimin e ftesës.

Përfaqësuesi i palës paditëse deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë, dhe kërkesëpadisë së precizuar si dhe pranë thënieve nga seancat e kaluara.

Në seancën kryesore u administruan këto prova: marrëveshja mbi kredinë nr. e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurit e dt.12.11.2007, plani I pagesës, kopja e letërnjoftimit të të paditurit, vendimi mbi lejimin e kredisë dhe kushtet e të njëjtës.

Provat e administruara gjykata i vlerësoi një nga një dhe në raport me njëra tjetrën dhe erdhi në këto përfundime:

Nuk është kontestuese fakti se paditësja dhe i padituri kanë lidhur marrëveshje mbi kredinë, pasi këtë fakt gjykata e vërteton nga marrëveshja mbi kredinë.

Nuk është kontestuese fakti se paditësi sipas përlogaritje së paditëses ka qenë i obliguar t'ia paguajë paditëses shumën prej 2,054.95 euro, pasi këtë fakt gjykata e konsteton nga bilanci apo pasqyra e obligimeve të pagesës.

Meqenëse përfaqësuesi i paditëses e zvogloi kërkesëpadinë, dhe kjo e drejtë nuk është në kundërshtim me nenin 3.3 të LPK-së, gjykata nuk ka mundësi t'ia mohoj paditëses një gjë të tillë pasi është në kuadër të kompetencave të saja, përkundër faktit se paditësja nuk prezantoi ndonjë provë që do të vërtetonte se I padituri e ka paguar ndonjë kist të kredisë.

Është parim se kontrata e lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse është Ligj për palët (pacta sund servanda).

Sipas Ligjit të Marëdhënieve të Detyrimeve (ligji I vjetër) pasi detyrimi ka lindur në kohën kur ky ligj ka qenë në fuqi neni 17 specifikon se pjesmarrësit e marëdhënies të detyrimeve kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij.


Pastaj neni 12 përmend faktin se pjesmarrësit e marëdhënies së detyrimit duhet ti përmbahen parimit të ndershmërisë dhe ndërgjegjshëmrisë.

Sa i përket kamatës gjykata e aprovoi kamatën e kërkuar nga ana e paditëse pasi është kamët e kontraktuar.

Sa i përket shpenzime procedurale gjykata u bazu në nenin 452 paragrafi I të LPK-së, ku pala e cila e ka humb kontestin duhet t'ia paguajë palës tjetër shpenzimet procedurale.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së vendosi si
në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.Nr.133/2012 datë: 17.04.2014



GJYQTARI
Faton Ademi

Faton Ademi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e
pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat 15 ditor nga dita e pranimit
së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë -- nëpërmjet kësaj gjykate.